

KUVENDI

NR 2367 DATE 22.09.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr _____ prot

Tiranë, më ___/9/ .2020

Lënda:

Depozitim nisme legislative

Drejtuar :

Z. GRAMOZ RUÇI

Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

I nderuar Z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, Ju dorëzojmë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën ligjore "Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Bashkëlidhur janë teksti i nismës dhe relacioni shoqërues i tij.

Deputeti propozues

Alket Hyseni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ / 2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 43, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) drejton dhe përgjigjet për hetimin e veprave penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të cilat janë kompetencë e prokurorisë që drejton.”

Neni 2

Pas nenit 107 shtohet neni 107/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 107/1

Marrëdhëniet me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, i japin informacion KQZ-së për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, personat nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin

nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë dhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

2. Informacioni sipas paragrafit 1 të këtij neni përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.
3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u përgjigjen kërkesave të KQZ-së për informacion jo më vonë se 15 ditë nga data e kërkesës.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Gramoz RUÇI